




FRANKLIN D. ROOSEVELT

President of the United States of America

TO ALL TO WHOM THESE PRESENTS SHALL COME, GREETING:

KNOW YE, That whereas an extradition treaty between the United States of America and Albania was concluded and signed by their respective Plenipotentiaries at Tirana on March 1, 1933, a true copy of which Convention is word for word as follows:

TREATY OF EXTRADITION BETWEEN THE
UNITED STATES OF AMERICA AND THE
KINGDOM OF ALBANIA

TRAKTAT EKSTRADIMI MIDIS SHTETE-
VET TE BASHKUAR T'AMERIKES EDHE
MBRETERISE SHQIPETARE.

The United States of America and Albania, desiring to promote the cause of justice, have resolved to conclude a treaty for the extradition of fugitives from justice between the two countries and have appointed for that purpose the following Plenipotentiaries:

The President of the United States of America: Herman Bernstein, Envoy Extraordinary and Minister Plenipotentiary of the United States of America to Albania;

Shtetet e Bashkuar t'Amerikës edhe Shqipëria, dyke dashur të vijnë në ndihmë të drejtësisë, kanë vendosur të lidhin midis të dy Shteteveve një traktat për ekstradimin e të aratësuarve që u shmangen drejtësisë dhe kanë emëruar për këtë qëllim Fuqiplo-
tët që vijojnë:

Presidenti i Shteteveve të Bashkuar t'Amerikës: Ekselencën e Tij Z. Herman Bernstein, i Dërguar i Jashtëzakonshëm dhe Ministër Fuqiplottë i Shteteveve të Bashkuar t'Amerikës në Shqipëri;

His Majesty the King of the
Albanians: His Excellency M.
Djafer Vila, Minister for Foreign
Affairs;

Who, after having communi-
cated to each other their respec-
tive full powers, found to be in
good and due form, have agreed
upon and concluded the following
articles:

ARTICLE I

It is agreed that the Govern-
ment of the United States and the
Government of Albania shall, upon
requisition duly made as herein
provided, deliver up to justice
any person who may be charged with,
or may have been convicted of, any
of the crimes or offenses speci-
fied in Article II of the present
Treaty committed within the juris-
diction of one of the High Con-
tracting Parties, and who shall
seek an asylum or shall be found
within the territories of the
other; provided that such surrender
shall take place only upon such
evidence of criminality, as accord-
ing to the laws of the place where

Nalt-Madhëria e Tij Mbreti
i Shqiptarëve: Ekselencën e Tij
Z. Djafer Vila, Ministër i
Punëve të Jashtme;

Të cilët, pasi i-a komuni-
kuan njërijetrit fuqit' e plotta
të tyre përkatëse, që u-gjентnë
në formë të mirë dhe të duhur,
ranë në ujdí dhe përfunduan ar-
tikujt që vijojnë:

ARTIKULL I

Qeveria e Shteteve të Bash-
kuar dhe Qeveria e Shqipërisë
pranojnë që t'i dorëzojnë drejtë-
sisë, mbi kërkimin e bërë regu-
llisht sikundër parashifet këtú,
cilindó person që munt të jetë
akuzuar osé munt të jetë dënuar
për cilindó prej delikteve të
caktuar në Artíkullin II të këtij
Traktati, kryer mbrenda juris-
diksionit të njërës nga Palët e
Nalta Kontraktúesë, dhe që ka
për të kërkuar strehë osé ka për
t'u ndodhur mbrenda tokës së
tjatrës; me konditë që ky dorëzim
do të bëhet vetëm pas asísh pro-
vash fajtorije që si mbas lígje-
vet të shtetit ku i aratísuri

the fugitive or person so charged shall be found, would justify his apprehension and commitment for trial if the crime or offense had been there committed.

ARTICLE II

Persons shall be delivered up according to the provisions of the present Treaty, who shall have been charged with or convicted of any of the following crimes or offenses:

1. Murder, (including crimes designated by the terms parricide, poisoning, and infanticide); manslaughter, when voluntary.

2. Malicious wounding or inflicting grievous bodily harm with premeditation.

3. Rape, abortion, carnal knowledge of children under the age of 15 years.

4. Abduction or detention of women or girls for immoral purposes.

5. Bigamy.

6. Arson.

osé personi i akuzuar si i këtillë ndodhet, munt të justifikojnë zënien dhe dorëzimin e tij për t'u gjykuar po të ish që delikti t'ish kryer atjë.

ARTIKULL II

Do të dorëzohen atá persona që, si mbas këtí Traktati, do të jenë akuzuar osé dënuar për cilindó prej delíkteve që vijoje:

1. Vrasje, (dyke përfshirë edhe deliktet e caktuar prej térmeve prindvrasje, helmím, dhe foshnjëvrasje); vrasje me qëllím.

2. Plagosje me qëllím osé lezió i rëndë trupór me paramendím.

3. Turpërim me violencë, dështím, turpërim fëmijësh nën moshën 15 vjetsh.

4. Rëmbím osé mbajtje grash osé vajzash për qëllime luksuri.

5. Bigamí.

6. Vënje zjarri me paramendím.

7. Willful and unlawful destruction or obstruction of railroads, which endangers human life.

8. Crimes committed at sea:

(a) Piracy, as commonly known and defined by the law of nations, or by statutes;

(b) Wrongfully sinking or destroying a vessel at sea or attempting to do so;

(c) Mutiny or conspiracy by two or more members of the crew or other persons on board of a vessel on the high seas, for the purpose of rebelling against the authority of the Captain or Commander of such vessel, or by fraud or violence taking possession of such vessel;

(d) Assault on board ship upon the high seas with intent to do bodily harm.

9. Burglary; house-breaking.

7. Prishje osé pengím me dashje dhe i pa-ligjshëm i hekurúdhave, që ve në rezík jetën njerëzore.

8. Delikte të kryer në det:

(a) Piratësi, sikundër njihet zakonisht dhe sikundër është caktuar prej të drejtës nërkombëtare osé prej ligjevet;

(b) Fundosje osé prishje pa të drejtë e një aníjeje në det osé tentativë për gjë të këtillë;

(c) Rebelím osé konspirím prej dy osé më shumë pjesëtarësh të ekipazhit osé personash të tjerë që ndodhen mbi një anie në det të hapët, me qëllím që të rebelojnë kundër autoritetit të Kapitenit osé Komandantit të kësáj aníjeje, osé me mashtrím osé violencë të shtjenë në dorë këtë anie;

(d) Msymje mbrenda në anie në det të hapët me qëllím lesioni trupór.

9. Hyrje dyke thyer osé hyrje

10. The act of breaking into and entering the offices of the Government or public authorities, or other buildings not dwellings with intent to commit a felony therein.

11. Robbery.

12. Forgery or the utterance of forged papers.

13. The forgery or falsification of the official acts of the Government or public authorities, including Courts of Justice, or the uttering or fraudulent use of any of the same.

14. The fabrication of counterfeit money, whether coin or paper, counterfeit titles or coupons of public debt, created by National, State, Provincial, Territorial, Local or Municipal Governments, bank notes or other instruments of public credit, coun-

me çdo mënyrë tjetër në godinë osé banesë për vjedhje.

10. Hyrja dyke thyer dhe hyrja me çdo mënyrë tjetër në zyrat qeveritare osé t'autoritëtevet publike, osé në të tjera ndërtesa që nuk janë banesa, me qëllim për të kryer një delikt aty mbrenda.

11. Vjedhje me violencë a frikësim.

12. Kontrafaqim dhe vumje në qarkullim letrash të kontrafaqura.

13. Kontrafaqim osé falsifikim i akteve zyrtare qeveritare osé t'autoritëtevet publike, dyke përfshirë edhe të Gjykatórevet të Drejtësisë, osé vumje në qarkullim osé përdorim me qëllim mashtrimi i një akti të tillë.

14. Fabrikim monedhash të kontrafaqúra, si metalike ashtú edhe karte, titujsh osé kuponash të kontrafaqúra të dettës publike, të emettúara prej Qeverivet Kombëtare, Shtetënore, Provinciale, Teritoriale, Lokale osé Bashkiake, bank-notash osé in-

terfeit seals, stamps, dies and marks of State or public administrations, and the utterance, circulation or fraudulent use of the above mentioned objects.

15. Embezzlement.

16. Kidnapping of minors or adults, defined to be the abduction or detention of a person or persons, in order to exact money from them, their families or any other person or persons, or for any other unlawful end.

17. Larceny, defined to be the theft of effects, personal property, or money, of the value of twenty-five dollars or more, or Albanian equivalent.

18. Obtaining money, valuable securities or other property by false pretenses, or receiving any money, valuable securities or other

strumentash të tjera të kredisë publike, vulash, timbrash, kallëpesh monedhe dhe shenjash të kontrafaqúra të administrátavet shtetënore osé publike, dhe nxjerja, qarkullimi osé përdorimi me qëllim mashtrimi i objektevet të sipërpërmendur.

15. Përvetím (keqpërdorím besimi).

16. Grabitje e të míturve osé e adultve, do me thënë rëmbím osé robërim i një personi osé personash, për të nxjerë pare prej tyre, prej famílieve të tyre osé prej nonjë personi tjetër osé personash të tjerë, osé për çfarëdó qëllim të pa-ligjshëm tjetër.

17. Vjedhje, do me thënë vjedhje teshash, sendesh personale, osé paresh, me vleftë prej njëzét e pesë dollarësh osé më tepër, osé me aqevleftë në monedhë shqiptare.

18. Obtením paresh, titujsh me vleftë osé pasunirash të tjera me dinakëri, osé marrje e çfarëdó páreje, titujsh me vleftë osé

property knowing the same to have been unlawfully obtained, where the amount of money or the value of the property so obtained or received exceeds two hundred dollars, or Albanian equivalent.

19. Perjury.

20. Fraud or breach of trust by a bailee, banker, agent, factor, trustee, executor, administrator, guardian, director or officer of any company or corporation, or by any one in any fiduciary position, where the amount of money or the value of the property misappropriated exceeds two hundred dollars, or Albanian equivalent.

21. Crimes and offenses

against the laws of both countries for the suppression of slavery and slave trading.

22. Wilful desertion or wilful non-support of minor or dependent children, or of other de-

pasunirash të tjera dyke ditur se këto kanë qënë shtënë në dorë me mënyra të pa-ligjshme, kur shuma e përeve osé vlefta e sëndevet të obtenúeme osé të marruna me këtë mënyrë kalón dy-qint dollarët osé nj'atë vleftë në monedhë shqiptare.

19. Dëshmím i remë.

20. Mashtrím osé keqpërdorím besimi nga ana e një depozitari, bankieri, agjenti, komisionari, të besúari (trustee), ekzekutori testamentar, administratori, tutori, drejtori osé zyrtari të çdo shoqërie osé korporate, osé nga ana e çfarëdó personi që mban një pozitë besimi (fiduciare), kur shuma e përeve osé vlefta e pasurisë së përvetuar kalón dy-qint dollarët osé ekuivalencën në monedhë shqiptare.

21. Delikte kundër ligjevet

të të dy Shtétevet për shdukjen e skllavërisë dhe kundër tregëtimit të skllévëve.

22. Neveritje dëshasi osé mospërkujdesje dëshazi fëmijësh të mitun osé të pa-zotë të

pendent persons, provided that the crime or offense is punishable by the laws of both countries.

23. Bribery.

24. Crimes or offenses against the bankruptcy laws.

25. Crimes or offenses against the laws for the suppression of traffic in narcotics.

26. Extradition shall also take place for participation in any of the crimes or offenses before mentioned as an accessory before or after the fact, or in any attempt to commit any of the aforesaid crimes or offenses.

ARTICLE III

The provisions of the present Treaty shall not import a claim of extradition for any crime or offense of a political character, nor for acts connected with such crimes or offenses; and no person surrendered by or to either of the High Contracting Parties in virtue of this Treaty shall be tried or punished for a political crime or offense committed before his ex-

shikojnë veten osë personash të tjerë të këtillë, me konditë që delikti të jetë i ndëshkuëshëm prej ligjevet të të dy shtetevet.

23. Mite.

24. Delikte kundër ligjeve të bankrutës.

25. Delikte kundër ligjeve për të shdukur trafikun e narkotikeve.

26. Gjith ashtu ekstradimi ka për t'u bërë edhe për bashkpunim në cilindó prej delíkteve të nalt-permendur si komplic para osë pas ngjarjes osë në cfarëdó tentative për të kryer cilindó prej delíktevet të sipërpërmendura.

ARTIKULL III

Dispozitat e këtij Traktati nuk japin të drejtë të kërkohet ekstradimi për ndonjë delíkt me karakter politik, as për vepra që kanë lidhje me kësísh delikte; dhe asnjë person i dorëzuar nga njëra Palë e Naltë Kontraktúese tjetrës Palë në themél të këtij Traktati nuk do të gjykohet osë ndëshkohet për ndonjë delíkt politik të kryer përpara eks-

tradition. The State applied to, or courts of such State, shall decide whether the crime or offense is of a political character.

When the offense charged comprises the act either of murder or assassination or of poisoning, either consummated or attempted, the fact that the offense was committed or attempted against the life of the Sovereign or Head of the State of one of the High Contracting Parties, or against the Sovereign or Head of a foreign State, or against the life of any member of his family, shall not be deemed sufficient to sustain that such crime or offense was of a political character, or was an act connected with crimes or offenses of a political character.

ARTICLE IV

No person shall be tried for any crime or offense, committed prior to his extradition, other than that for which he was surrendered, unless he has been at liberty for one month after having been tried, to leave the

tradimit të tij. Shteti prej të cilit kërkohet ekstradimi, osé Gjykatoret e këtij Shteti, do të vendosin nëse delikti ka karakter politik. Kur faji i ngarkuar është osé vrasje osé asasinim osé helmim, qoftë i kryer qoftë i tentuar, fakti që faji është kryer osé tentuar kundër jetës së Sovranit osé Shefit të Shtetit të njërit nga Palët e Nalta Kontraktuese, osé kundër Sovranit osé Shefit të një Shteti të huaj, osé kundër jetës së ndonjanit prej anëtarëve të families së tij, mjafton për të mos i dhënë këtij delikti karakter politik as për t'a lidhur këtë me delikte me karakter politik.

ARTIKULL IV

Askush nuk do të gjykohet për ndonjë delikt të kryer përpara ekstradimit të tij, veç se për deliktin për të cilin është dorëzuar, posë rastit kur ky ka qënë i lirë për një muaj resht të dalë jashtë shtetit passí të ketë

country, or, in case of conviction, for one month after having suffered his punishment or having been pardoned.

ARTICLE V

A fugitive criminal shall not be surrendered under the provisions hereof, when, from lapse of time or other lawful cause, according to the laws of the demanding country, the criminal is exempt from prosecution or punishment for the offense for which the surrender is asked.

ARTICLE VI

If a fugitive criminal whose surrender may be claimed pursuant to the stipulations hereof, be actually under prosecution, out on bail or in custody, for a crime or offense committed in the country where he has sought asylum, or shall have been convicted thereof, his extradition may be deferred until such proceedings be determined, and until he shall have been set at liberty in due course of law.

qënë gjykuar, osë në rast dënimi, të ketë vùajtur ndëshkimin osë të jetë falur.

ARTIKULL V

Një kriminál i aratisur nuk do të dorëzohet në mbështetje të dispozítavet të këtí Traktati, kur, për shkak parashkrimi osë për arsye ligjore tjetër, si mbas lígjevet të Shtetit kërkuës, kriminali përjashtohet nga ndjekja osë ndëshkimi për deliktin për të cilin kërkohet ekstradimi.

ARTIKULL VI

Kur një kriminál i aratisur, ekstradimi i të cilit kërkohet si mbas stipulátavet të këtí Traktati, ndodhet nën ndjekje, është i liruar me garancí, osë mbahet i burgosur, për ndonjë delikt të kryer në shtetin ku ka kërkuar strehë, osë ka qënë dënuar për atë delíkt, ekstradimi i tij munt të shtyhet deri sa ndjekjet në fjalë të jenë përfunduar, dhe aý të jetë i liruar si mbas dispozítavet ligjore.

ARTICLE VII

If a fugitive criminal claimed by one of the two parties hereto, shall be also claimed by one or more powers pursuant to treaty provisions, on account of crimes or offenses committed within their jurisdiction, such criminal shall be delivered to that State whose demand is first received unless the demand is waived.

This article shall not affect such treaties as have previously been concluded by one of the contracting parties with other States.

ARTICLE VIII

Under the stipulations of this Treaty, neither of the High Contracting Parties shall be bound to deliver up its own citizens, except in cases where such citizenship has been obtained after the perpetration of the crime for which extradition is sought. The State appealed to shall decide whether the person claimed is its own citizen.

ARTIKULL VII

Kur një kriminal i aratisur që reklamohet prej njëres nga të dy palët e kësaj marrëveshjeje, kërkohet edhe prej një ose më tepër shteteve në bazë dispozitash të traktateve, për delikte të kryer mbrenda jurisdiksioneve të tyre, ky kriminal do t'i dorëzohet atij Shteti, kërkesa e të cilit ka arritur e para, veç kur hiqet dorë nga kërkesa.

Ky artikull nuk do të çenojë traktatet që janë lidhur qysh më parë prej njëres ose tjetres nga Palët Kontraktuese me Shtete të tjerë.

ARTIKULL VIII

Si mbas stipulatavet të këtij Traktati, as njëra nga Palët e Nalta Kontraktuese nuk do të jetë e detyruar të ekstradojë shtetasët e vetë, veç kur shtetësia është marrë pas kryerjes së deliktit për të cilin kërkohet ekstradimi. Shteti prej të cilit kërkohet ekstradimi ka me vendosë nëse personi i reklamuar është shtetas i tij.

ARTICLE IX

The expense of transportation of the fugitive shall be borne by the government which has preferred the demand for extradition. The appropriate legal officers of the country where the proceedings of extradition are had, shall assist the officers of the government demanding the extradition before the respective judges and magistrates, by every legal means within their power; and no claim other than for the board and lodging of a fugitive prior to his surrender, arising out of the arrest, detention, examination and surrender of fugitives under this treaty, shall be made against the government demanding the extradition; provided, however, that any officer or officers of the surrendering government giving assistance, who shall, in the usual course of their duty receive no salary or compensation other than specific fees for services performed, shall be entitled to receive from the government de-

ARTIKULL IX

Shpenzimet e transportimit të të aratísurit do të paguhen prej qeverisë që paraqét kërkesën për ekstradím. Nënúnësët kompetentë të drejtësisë së shtetit ku janë dyke u kryer vepërimet e ekstradimit, do të ndihmojnë nënúnësët e qeverisë që kërkon ekstradimin përpara gjykátësve dhe magjistrátëve përkatës, me të gjitha mjetet ligjore që disponojnë; dhe asnjë shpenzím nuk do të kërkohet nga qeveria që reklamón ekstradimin përveç shpenzímevet për ushqimin dhe fjetjen e të aratísurit përpara dorëzimit të tij, të shkakëtúara prej arrestimit, burgimit, hetimit dhe ekstradimit të të aratísurit si mbas këtí Traktati; por me konditë që, nënúnësi osé nënúnësët e qeverisë dorëzúëse që ndihmojnë, të cilët në vazhdím të rëgulltë të detyrës së tyre nuk kanë për të marrë asnjë rrogë osé shpërblím veç táksave specifike për shërbime të kryera, do të kenë të drejtë të marrin nga

manding the extradition the customary fees for the acts or services performed by them in the same manner and to the same amount as though such acts or services had been performed in ordinary criminal proceedings under the laws of the country of which they are officers.

ARTICLE X

Everything found in the possession of the fugitive criminal at the time of his arrest, whether being the proceeds of the crime or offense, or which may be material as evidence in making proof of the crime, shall so far as practicable, according to the laws of either of the High Contracting Parties, be delivered up with his person at the time of surrender. Nevertheless, the rights of a third party with regard to the articles referred to, shall be duly respected.

ARTICLE XI

The stipulations of the present Treaty shall be applicable to

qeveria që kërkon ekstradimin, taksat e zakonëshme për veprimet ose shërbimet e kryera prej tyre në mënyrën dhe në sasinë sikur këto veprime ose shërbime të ishin kryer në proceset penale ordinare si mbas ligjeve të Shtetit në shërbimin e të cilit ndodhen si nënpunës.

ARTIKULL X

Çdo send që gjendet në posedimin e kriminalit të aratitur në kohën e arrestimit të tij, qoftë se këto sende rjedhin nga delikti, qoftë se munt të përdoren si material prove në provimin e deliktit, me sa të jetë e mundur, si mbas ligjeve të seicilës nga Palët e Nalta Kontraktuese, do të dorëzohen së bashku me personin në kohën e ekstradimit të tij. Sidoqoftë, të drejtat e një personi të tretë përsá u përkët sendeve të naltpërmëndura, do të respektohen duhësisht.

ARTIKULL XI

Stipulatat e këtij Traktati do të jenë t'aplikueshme në të

all territory wherever situated, belonging to either of the High Contracting Parties or in the occupancy and under the control of either of them, during such occupancy or control.

Requisitions for the surrender of fugitives from justice shall be made by the respective diplomatic agents of the High Contracting Parties. In the event of the absence of such agents from the country or where extradition is sought from territory included in the preceding paragraphs, other than the United States or Albania, requisitions may be made by superior consular officers.

The arrest of the fugitive shall be brought about in accordance with the laws of the respective countries, and if, after an examination, it shall be decided, according to the law and the evidence, that extradition is due pursuant to this treaty, the fugitive shall be surrendered in con-

gjitha tokat kudó që të ndodhen, që janë nën zotërimin e njërës osé tjetrës nga Palët e Nalta Kontraktúesse osé nën okupimin dhe nën kontrollimin e njërës osé tjetrës prej tyre, sa kohë që vazhdón ky okupím osé kontrollím.

Kërkesat për ekstradimin e të aratísurve nga drejtësia do të bëhen me anën e agjéntëve diplomatikë përkatës të Pálëvet të Nalta Kontraktúesse. Në rast të mos-ndodhjes së agjéntëve të tillë në Shtet osé kur ekstradimi kërkohet nga ndonjë tokë e përfshirë në paragrafet e parakalum, posë Shtétevet të Bashkuar osé Shqipërisë, kërkesat munt të bëhen me anën e zyrtárëve eprorë konsullorë.

Arrestimi i të aratísurit do të bëhet në konformitét me ligjet e Shtétevet respektive, dhe nësé, pas një shqyrtimi, do të vendoset, si mbas ligjës dhe provavet, që ekstradimi duhet të akordohet në bazë të këtí Traktati, i aratísuri do të dorëzohet në konformitét me format e ligjës

formity to the forms of law prescribed in such cases.

The person provisionally arrested, shall be released, unless within two months from the date of arrest in Albania, or from the date of commitment in the United States, the formal requisition for surrender with the documentary proofs hereinafter prescribed be made as aforesaid by the diplomatic agent of the demanding Government, or, in his absence, by a consular officer thereof.

If the fugitive criminal shall have been convicted of the crime or offense for which his surrender is asked, a copy of the sentence of the court before which such conviction took place, duly authenticated, shall be produced. If, however, the fugitive is merely charged with crime, a duly authenticated copy of the warrant of arrest in the country where the crime was committed shall be produced, together with the evidence of criminality mentioned in Arti-

që disponojnë për kësish raste.

Personi i arrestuar përko-hësisht, do të lirohet, veç në rastin kur mbrenda dy muajve nga data e arrestimit në Shqipëri osë në Shtetet e Bashkuar, kërkesa formale për dorëzim bashkë me dokumentat provuese të përshkruara këtú poshtë do të jenë paraqitur sikundër që përmendet këtú sipër prej agjentit diplomatik të Qeverisë kërkuëse, osë, në mungesë të tij, prej një nënpúnësi konsullór të asáj Qeverie.

Në rast se kriminali i aratisur do të jetë dënuar për deliktin për të cilin kërkohet ekstradimi i tij, duhet të paraqitet një kópie, duhësisht e autentikuar, e vendimit të gjykatores që ka caktuar këtë dënim. Por, kur i aratísuri është vetëm akuzuar me delíkt, do të paraqitet një kópie, duhësisht e autentikuar, e mandatit t'arrestimit të Shtetit ku është kryer delikti, së bashku me provën e fajësisë të përmendur në Artí-

cle I hereof.

ARTICLE XII

The present Treaty, of which the English and Albanian texts are equally authentic, shall be ratified by the High Contracting Parties in accordance with their respective constitutional methods, and shall take effect on the date of the exchange of ratifications which shall take place at Washington as soon as possible.

ARTICLE XIII

The present Treaty shall remain in force for a period of five years, and in case neither of the High Contracting Parties shall have given notice one year before the expiration of that period of its intention to terminate the Treaty, it shall continue in force until the expiration of one year from the date on which such notice of termination shall be given by either of the High Contracting Parties.

In witness whereof the above named Plenipotentiaries have

kullin I të këtij Traktati.

ARTIKULL XII

Ky Traktat, tekstet anglisht dhe shqip të të cilit janë njësisht autentike, do të ratifikohet prej Palëvet të Nalta Kontraktuese në konformitet me rëgullat konstitucionale respektive dhe do të hyjë në fuqi ditën e shkëmbimit të ratifikimevet që do të bëhet në WASHINGTON sa më shpejt që të jetë e mundur.

ARTIKULL XIII

Ky Traktat do të mbetet në fuqi për një periudë prej pesë vjetsh, dhe në rast se as njëra nga Palët e Nalta Kontraktuese nuk do të ketë njoftuar një vjet para mbarimit të asaj periude qëllimin e vetë për t'i dhënë fund Traktatit, ky do të vazhdojë të mbesë në fuqi deri në mbarimin e një vjeti prej datës në të cilën të jetë dhënë një njoftim i tillë prej njëres ose tjetres nga Palët e Nalta Kontraktuese.

Në dëshmi të të cilëve
Fuqplotët e përmendur sipër e

signed the present Treaty and
have hereunto affixed their seals.

kanë nënshkruar këtë Traktat dhe
kanë vënë vulat e tyre mbi
'të.

Done in duplicate at Tirana
this first day of March, nineteen
hundred and thirty-three.

Bërë në duplikatë në Tiranë
sot të parën ditë të Marsit, një
mij' e nëntë qint e tridhjet' e
tre.

HERMAN BERNSTEIN

DJAFER VILA


AND WHEREAS, the Senate of the United States of
America by their resolution of February 2 (Legislative
Day, January 23), 1934, (two-thirds of the Senators
present concurring therein) did advise and consent to
the ratification of the said Convention;

NOW, THEREFORE, be it known that I, Franklin D.
Roosevelt, President of the United States of America,
having seen and considered the said Convention, do
hereby, in pursuance of the aforesaid advice and con-
sent of the Senate, ratify and confirm the same and
every article and clause thereof.

IN TESTIMONY WHEREOF, I have caused the seal of

the United States of America to be hereunto affixed.

DONE at the city of Washington
this twenty-first day of February
in the year of our Lord
one thousand nine hun-
dred and thirty-four,
and of the Independ-
ence of the United
States of America the
one hundred and fifty-eighth.



Franklin D. Roosevelt

By the President:

Cordell Hull

Secretary of State.